



FTESË PUBLIKE PËR PROJEKTET KULTURORE, RINORE E SPORTIVE PËR OJQ PËR VITIN 2024

Udhëzimet për Aplikantët

Data e hapjes së ftesës publike:

30.04.2024

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 15 ditë pune dhe përfundon me datën

23.05.2024

Përmbajtja

1. FTESË PUBLIKE PËR PROJEKTET KULTURORE-ARTISTIKE,RINORE E SPORTIVE PËR OJQ PËR VITIN 2024

1.1 Fushat e përkrahjes së projekteve:

1.2 Objektivat e thirrjes publike.....

1.3 Vlera e planifikuar për projektet kulturore artistike,rinore dhe sportive
.....

2. KUSHTET FORMALE TË FTESËS PUBLIKE.....

2.1. Kush mund të aplikoj?

2.2 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen për këtë ftesë publike

3. SI TË APLIKONI?.....

3.1 Aplikacioni i projekt propozimit

3.2 Përmbajtja e formularit të Buxhetit.....

3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?.....

3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

4.1. Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:.....

4.2 Dokumentacion shtesë dhe kontraktimi

KALENDARI I REALIZIMIT TË FTESËS PUBLIKE

LISTA E DOKUMENTEVE TË FTESËS PUBLIKE.....

1. FTESË PUBLIKE PËR PROJEKTET KULTURORE-ARTISTIKE, RINORE DHE SPORTIVE PËR OJQ PËR VITIN 2024

1.1 Fushat e përkrahjes së projekteve:

- **Komuna e Kaçanikut** u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare në komunën e Kaçanikut, programi i punës i të cilave është i fokusuar në mbështetje financiare për projektet që i kontribuojnë objektivit të përgjithshëm: *Avancimin dhe afirmimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe rinore në Kaçanik.*

Objektivat specifike të kësaj Thirrje janë:

- a) Mbeshtetja, nxitja, fuqizimin, zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve të përgjithshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit
- b) Organizimi i ngjarjeve me karakter bashkëpunimi për promovimin e vlerave në fushat e kulturës rinisë dhe sportit
- c) Përfshirja e të rinjve në aktivitetet kulturore, rinore e sportive;

NË FUSHËN E KULTURËS

- *Shënimet e datave historike kulturore, vendore e ndërkombëtare .*

NË FUSHËN E RINISË E SPORTIT

- *Përkrahja e klubeve publike sportive;*
- *Avancimi i aktiviteteve në klubet sportive dhe masovizimi i sportit për të rinjë ;*
- *Përkrahja për klubet që funksionojnë në komunën e Kaçanikut, do të mbështeten bazuar në realizimin e suksesshëm të aktiviteteve/ programeve të tyre rinore e sportive në vitet paraprake dhe planprogramit të tyre të punës për vitin 2024.*

1.2 Objektivat e ftesës publike

Objektivat e përgjithshme:

- Profesionale, të cilat me kualitetin e tyre formal dhe përmbajtësor i respektojnë standartet krijuese europiane dhe botërore
- Promovuese, të cilat kanë për qëllim paraqitjen dhe integrimin e artistëve, rinisë dhe sportistëve
- Stimuluese, të cilat kanë për qëllim evidentimin e talentëve të rinjë në fushat përkatëse me ide të veçanta kreative;
- Tradicionale, përmes të cilave do të promovohen vlerat kulturore, rinore e

sportive

- Inovative, të cilat me formën, përmbajtjen, frymën dhe mënyrën e realizimit të tyre paraqesin risi për amientin krijues;
- Kritike, të cilat me formën dhe përmbajtjen e tyre nxisin debat dhe diversitet artistik, kulturor e sportive.

1.3 Vlera e planifikuar për projektet kulturore artistike, rinore e sportive

a) Shuma e mbështetjes financiare për projektet e OJQ-ve për kulture, rini e sport do të jetë **16550 €**

- ❖ **SEKTORI I KULTURËS (Subvencionimet totale në vlerë të **1000 €**)**
- ❖ **SEKTORI I RINISË DHE SPORT (Subvencionimet totale në vlerë të **15550 €**)**

2. KUSHTET FORMALE TË FTESËS PUBLIKE

2.1. Kush mund të aplikoj?

Të gjitha Organizatat e regjistruara si OJQ (sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës të cilat veprojnë në Komunën e Kaçanikut ,programi i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

- OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti 2 projekte projekte në kuadër të kësaj ftese publike. Periudha e zbatimit të projektit është më së largu deri me 31 dhjetor 2024.
- Të drejtë aplikimi nuk kanë organizatat/klubet të cilat kanë përfituar në vitin 2024 nga thirrjet e shpallura nga DKRS në Kaçanik.

2.2 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen për këtë ftese publike

Nëpërmjet fondeve publike të kësaj ftese publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

3. SI TË APLIKONI?

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5)

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve,

kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e ftesës publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë ftesë publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

3.1 Aplikacioni i projekt-propozimit

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikuesit dhe përmbajtjen e projektit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Formulari është i nevojshëm të plotësohet me kompjuter. Nëse formulari është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

3.2 Përmbajtja e formularit të buxhetit

Formulari i propozim-buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim- buxheti i dorëzuar duhet të përmbajë informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit të propozuar për financim.

Nëse formulari i buxhetit nuk është i plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?

Formularët e detyrueshëm dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (një origjinal). Formularët duhet të jenë të nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar dhe të vulosur me vulën zyrtare të organizatës. Aplikimi origjinal duhet të dërgohet personalisht **(Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5)**

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin për fushën përkatëse për të cilin aplikon.

Aplikacionet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5)

3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i thirrjes është: 15 ditë pune, përkatësisht prej datës **30.04.2024** deri më **23.05.2024**. Kërkesa është dorëzuar brenda periudhës së ftesës nëse vula pranuese tregon se është marrë në postë deri në fund të datës së ftesës, si afati i fundit për dorëzimin. Në rast se kërkesa është paraqitur personalisht në zyrë, aplikantit do t'i lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysht.

3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresën e mëposhtme: hafize.sallahi@rks-gov.net, jo më vonë se 8 ditë para skadimit të ftesës.

Përgjigjet ndaj kërkesave të veçanta do të dërgohet direkt në adresën e pyetjeve të shtruara, dhe përgjigjet më të shpeshta do të publikohen në faqen e mëposhtme të internetit: <https://kk.rks-gov.net/kacanik/> dhe jo më vonë se **8 ditë** para skadimit të thirrjes. Për të siguruar trajtim të barabartë të të gjithë aplikantëve të mundshëm, një ofruer i mbështetjes financiare publike nuk mund të japë një mendim paraprak për pranueshmërinë e aplikantëve, veprimet apo shpenzimet e përmendura në kërkesë.

4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurat e mëposhtme:

- Ofruesi i mbështetjes financiare do të themeloj një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë, nga zyrtarë të institucionit dhe ekspertë tjerë të jashtëm, të cilët kanë për detyrë të vlerësojnë aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.
- Pas kontrollimit të të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë të të gjithë aplikantëve që i plotësojnë kushtet për t'u vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve, të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.
- Komuna e Kaçanikut- DKRS do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.
- Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.
- Lista e përkohshme e projekteve përfituese të përzgjedhura për financim. Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve, të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, komisioni do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma totale e kostos së projekteve të radhitura në listën e përkohshme nuk do të kalojë shumën totale të ofruar për financim përmes thirrjes publike.

Dokumentacion shtesë dhe kontraktimi

Komuna e Kaçanikut- DKRS do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, DKRS mund të kërkojë shqyrtimin e vijave buxhetore për kostot e vlerësuar që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse përfituesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së

caktuar përfituesi do të refuzohet. Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve të përzgjedhura për financim dhe I rekomandon kryetarit të komunës për aprovim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët, aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve.

KALENDARI I REALIZIMIT TË FTESËS PUBLIKE

Fazat e procedurës së thirrjes

1. Afati i fundit për aplikimet: **23.05.2024**
2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen: **8 ditë para mbylljes së Ftesës për Aplikim**
3. Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimi aplikantëve: **1 muaj pas përfundimit të Ftesës Publike**

LISTA E DOKUMENTEVE TË FTESËS PUBLIKE

Formularët mund ti gjeni në ëeb-faqe: <https://kk.rks.gov.net/kacanik/>

- Certifikata e numrit të regjistrimit dhe numrit fiskal të organizatës ;
- Vërtetimi i regjistrimit pranë Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kaçanik;
- Vërtetimi i licencimit pranë Federatës Përkatëse dhe MKRS -së (vetëm për klubet sportive);
- Letërnjoftimi i personave (aplikantit) që përfaqëson organizatën dhe menagjerit të projektit ;
- Xhirollogaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës, më i ri se 3 muaj ;
- Dëshmi se nuk ka organizata obligime ndaj ATK-së;

Dokumentacioni i cili shkarkohet nga ëeb faqja e Komunës së Kaçanikut :

1. Formullari i aplikacionit për projekt programin (Formulari F9)
2. Formullari i propozim buxhetit (Formulari F10)
3. Formën e deklaratës për mungesën e financimit të dyfishtë (Formulari F11)
4. Forma e deklarimit të programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike (Formulari F13)
5. Forma e Deklaratës së partneritetit, nëse është e aplikueshme (Formulari F12)
6. Deklaratë e aktiviteteve të kontraktorit të përmendura në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin e projektit, nëse është e aplikueshme (Formulari F14).
7. **Dokumentacioni i aplikimit duhet të printohet të nënshkruhet nga menagjeri i projektit dhe përfaqësuesi i OJQ-së dhe të vuloset . Ky dokumentacion i dorzuar në tërsi skanohet dhe dorzohet bashkë me gjitha dokumentet përcjellëse në CD ose USB (obligative)**